



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës :** KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,  
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Trupi Gjykesues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 25 korrik 2025

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Urdhër i Mëtejshëm mbi Planifikimin e Paraqitjes së Provave të Mbrojtjes dhe  
Çështje të Lidhura me Të**

---

**Prokurores së Specializuar**

Kimberli P. Uest

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit**

Luka Mishetiç

**Mbrojtjes së Viktimave**

Sajmon Loz

**Mbrojtjes së Kadri Veselit**

Rodni Dikson

**Mbrojtjes së Rexhep Selimit**

Xhefri Roberts

**Mbrojtjes së Jakup Krasniqit**

Venkatesvari Alagenda

**TRUPI GJYKUES II** ("Trupi Gjykses"), në bazë të neneve 21(1), (2) dhe 4(c) dhe (d), dhe 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 9(5)(a), 104(5), 107, 116, dhe 119 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 7 tetor 2022, Mbrojtja e Hashim Thaçit ("Mbrojtja e Thaçit") njoftoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake dhe palët dhe pjesëmarrësit e tjerë se do të kërkonte masa për mundësi hetimore unike për ruajtjen e dëshmive të nëntë dëshmitarëve që Mbrojtja e Thaçit pati ndërmend të thërriste sipas rregullës 99 gjatë paraqitjes së provave të saj, ose si alternativë, marrjen e deponimeve sipas rregullës 100 ("Njoftimi").<sup>1</sup>

2. Më 28 tetor 2022, pas urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,<sup>2</sup> Mbrojtja e Thaçit dorëzoi një mocion ku arsyetonte nevojën për masat e kërkuara dhe ndër të tjera, dorëzoi identitetet e tetë prej dëshmitarëve të propozuar ("Mocioni i Mbrojtjes së Thaçit për Mundësi Hetimore Unike" ose "Mocioni").<sup>3</sup> Më 11 nëntor 2022, Mbrojtja e Thaçit dorëzoi një shtesë të Mocionit ("Shtesa"), ku arsyetonte nevojën për masat e kërkuara lidhur me dëshmitarin e nëntë.<sup>4</sup> Më 23 nëntor 2022,

---

<sup>1</sup> F01018, Mbrojtja, *Njoftim i Mbrojtjes së Thaçit për Mundësi Hetimore Unike*, 7 tetor, para. 5, 16.

<sup>2</sup> Transkripti i seancës, 8 shtator 2022, f. 1582, rreshti 21, deri në f. 1583, rreshti 6.

<sup>3</sup> F01068, Mbrojtja, *Mocion i Mbrojtjes së Thaçit që Përligj Kërkesën për Mundësi Hetimore Unike*, 28 tetor 2022, konfidencial, para. 9 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 1 nëntor 2022, F01068/RED).

<sup>4</sup> F01099, Mbrojtja, *Shtesë e Mocionit të Mbrojtjes së Thaçit që Përligj Kërkesën për Mundësi Hetimore Unike*, 11 nëntor 2022, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 22 nëntor 2022, F01099/RED; versioni i korrigjuar u dorëzua më 24 Nëntor 2022, F01099/COR).

pas përgjigjes së ZPS-së (“Përgjigjja ndaj Shtesës”),<sup>5</sup> Mbrojtja e Thaçit iu kundërpërgjigj Përgjigjes ndaj Shtesës (“Kundërpërgjigjja lidhur me Shtesën”).<sup>6</sup>

3. Në mbështetje të Mocionit të vet, Mbrojtja e Thaçit argumentoi se ekzistonte një mundësi hetimore unike në lidhje me nëntë dëshmitarët ndërkombëtarë, provat e të cilëve janë thelbësore ose kyçe për argumentet e Mbrojtjes, dhe që mund të mos jenë në dispozicion gjatë gjykimit.<sup>7</sup> Mbrojtja e Thaçit tha se do të parapëlqente t’i thërriste dëshmitarët gjatë fazës së paraqitjes së provave të veta, pas mbylljes së paraqitjes së provave të ZPS-së, por mosha e shtyrë dhe shëndeti i dëshmitarëve mund ta pengojë Mbrojtjen nga kjo në kohën që Mbrojtja do të nisë paraqitjen e provave të veta.<sup>8</sup> Për këtë qëllim, Mbrojtja e Thaçit: (i) kërkoi që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të ftonte Kryetaren të “caktojë të paktën një anëtar të Trupit Gjykes apo mundësisht, të tre anëtarët e tij për të ‘marrë pjesë’ në mundësinë hetimore unike për ruajtjen e këtyre provave përpara gjykimit”; dhe (ii) propozoi që, nëse dëshmitarët do të ishin në gjendje të mirë për të udhëtuar, dëshmitë e tyre të merreshin në sallën e gjyqit të Dhomave të Specializuara të Kosovës, në prani të të akuzuarit.<sup>9</sup> Mbrojtja e Thaçit insistoi se koha kur vlerësohej të fillonte paraqitja e provave të Mbrojtjes, dhe mosha e dëshmitarëve, ishin një parametër tjetër i rëndësishëm që duhej të mbahej parasysh.<sup>10</sup>

4. Në Shtesën e vet, Mbrojtja e Thaçit bëri të ditur se sapo kishte marrë miratimin e autoriteteve përkatëse, dhe tani ishte në gjendje të kërkonte masa për

---

<sup>5</sup> F01112, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Shtesës së Mocionit të Thaçit për Mundësi Hetimore Unike*, 18 nëntor 2022.

<sup>6</sup> F01120, *Mbrojtja, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë për Shtesën e Mocionit të Mbrojtjes që Përligj Kërkesën për Mundësi Hetimore Unike*, 23 nëntor 2022, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 5 dhjetor 2022, F01120/RED).

<sup>7</sup> Mocioni i Mbrojtjes së Thaçit për Mundësi Hetimore Unike, para. 15; *shih gjithashtu* para. 35-36.

<sup>8</sup> *Shih* Mocionin e Thaçit për Mundësi Hetimore Unike, para. 9-16; Shtesën, para. 2, 14, 20-21; Njoftimin, para. 5-6, 11, 16.

<sup>9</sup> Njoftimi, para. 13 dhe 16; Mocioni, para. 13; Shtesa, para. 11, 16. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen lidhur me Shtesën, poshtëshënimin 1.

<sup>10</sup> Mocioni i Mbrojtjes së Thaçit për Mundësi Hetimore Unike, para. 17-25. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen lidhur me Shtesën, para. 8-9.

dëshmitarin e nëntë të mundshëm, të përmendur fillimisht në Njoftim.<sup>11</sup> Krahas kësaj, në Kundërpërgjigjen lidhur me Shtesën, Mbrojtja e Thaçit shpjegoi se kishte dorëzuar Shtesën menjëherë pas marrjes së autorizimit nga autoritetet përkatëse.<sup>12</sup>

5. Në Shtojcat konfidenciale 1-8 të Mocionit të Mbrojtjes së Thaçit për Mundësi Hetimore Unike, Mbrojtja e Thaçit dorëzoi të dhëna që i përshkroi si “një përmbledhje e saktë për secilin dëshmitarë të propozuar”, që përfshin (i) emrin; (ii) moshën dhe/ose datën e lindjes; (iii) vendndodhjen; dhe (iv) deklaratën mbi aspektet për të cilat do të pyetet dëshmitari.<sup>13</sup> Në atë Mocion, Mbrojtja e Thaçit bëri edhe këto parashtime:

17. I rëndësishëm për përligjen e kërkesës së Mbrojtjes është vlerësimi se kur do të fillojë paraqitja e provave të Mbrojtjes dhe mosha që do të kenë dëshmitarët në atë kohë – d.m.th, a mund të presë Mbrojtja derisa të fillojë me paraqitjen e provave të veta për t’i thirrur ata? Si në çdo gjykim penal tjetër, kjo nuk është shkencë ekzakte, megjithatë, Mbrojtja është përpjekur të bëjë një vlerësim në bazë të informacionit që ka në lidhje me vëllimin e provave të ZPS-së, sikurse shtjellohet më poshtë.<sup>14</sup>

6. Mbrojtja e Thaçit më tej bëri të ditur se të gjithë dëshmitarët e mundshëm me të cilët Mbrojtja ishte në kontakt, janë të disponueshëm në shkurt 2023, përveç njërit i cili do të jetë i disponueshëm në prill 2023, dhe sugjeroi që ata të japin dëshmitë e tyre në ato periudha.<sup>15</sup>

7. Më 28 nëntor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hodhi poshtë Mocionin e Mbrojtjes së Thaçit për Mundësi Hetimore Unike.<sup>16</sup> Në atë Vendim, Gjykatësi i

---

<sup>11</sup> Shtesa, para. 2.

<sup>12</sup> Kundërpërgjigjja lidhur me Shtesën, para. 5. *Shih gjithashtu* F01125, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes së Thaçit që Përligj Kërkesën për Mundësi Hetimore Unike* (“Vendimi mbi Mocionin e Mbrojtjes së Thaçit që Përligj Kërkesën për Mundësi Hetimore Unike”), 28 nëntor 2022, para. 25.

<sup>13</sup> Mocioni i Mbrojtjes së Thaçit për Mundësi Hetimore Unike, para. 11 dhe Shtojcat 1-8.

<sup>14</sup> Mocioni i Mbrojtjes së Thaçit për Mundësi Hetimore Unike, para. 17.

<sup>15</sup> Mocioni i Mbrojtjes së Thaçit për Mundësi Hetimore Unike, para. 33.

<sup>16</sup> Vendimi mbi Mocionin e Mbrojtjes së Thaçit që Përligj Kërkesën për Mundësi Hetimore Unike, para. 30, 34, 36(a).

Procedurës Paraprake bëri të qartë se vendimi i tij nuk cenonte asnjë parashtrim në lidhje me modalitetet, kohën dhe kronologjinë e dëshmimeve të dëshmitarëve, që mund t'i paraqitej në të ardhmen trupit gjykues që do të ngarkohej me këtë çështje.<sup>17</sup>

8. Më 9 janar 2023, Mbrojtja e Thaçit dorëzoi kërkesë për ruajtjen e provave të të njëjtëve nëntë dëshmitarëve të “rëndësishëm dhe thelbësor”, në të cilën përsëriti synimin për të thirrur nëntë dëshmitarët e propozuar gjatë paraqitjes së provave të saj dhe kërkoi sërish që dëshmia e tyre të ruhej sipas rregullave 99 dhe/ose 100.<sup>18</sup> Mbrojtja e Thaçit identifikoi të njëjtit nëntë dëshmitarë të mundshëm, dhe në Shtojcat konfidenciale 1-9 përfshiu përsëri informacion në lidhje me identitetet e dëshmitarëve të propozuar dhe një deklaratë përmbledhëse mbi aspektet për të cilat do t'u bëheshin pyetje.<sup>19</sup> U paraqitën sërish dhe u përsëritën argumente të ngjashme me ato të shtjelluara më lart. Si arsyetim për kërkesën, Mbrojtja e Thaçit theksoi përsëri moshën dhe shëndetin e dëshmitarëve të mundshëm dhe parashtrori se, sipas vlerësimit të saj, Mbrojtja e Thaçit me gjasë nuk do të mund të fillonte me paraqitjen e provave të veta deri “në fund të 2025”.<sup>20</sup> Mbrojtja e Thaçit argumentoi se këta dëshmitarë do të duhej të dëshmonin “pa renditje të caktuar” pas datës 1 mars 2023 dhe se të gjithë dëshmitarët e mundshëm me të cilët Mbrojtja e Thaçit ishte në kontakt ishin të disponueshëm në mars 2023, përveç njërit i cili do të ishte i disponueshëm dhe jepte dëshmi në prill 2023.<sup>21</sup>

---

<sup>17</sup> Vendimi mbi Mocionin e Mbrojtjes së Thaçit që Përligj Kërkesën për Mundësi Hetimore Unike, para. 31 (dhe para. 29 dhe 34).

<sup>18</sup> F01191, Mbrojtja, *Mocion i Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Ruajtjen e Provave të Mbrojtjes* (“Mocioni i Mbrojtjes së Thaçit për Ruajtjen e Provave të Mbrojtjes”), 9 janar 2023, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 14 shkurt 2023, F01191/RED), para. 2, 10, 42, me Shtojcat 1-9, konfidenciale.

<sup>19</sup> *Shih* Shtojcat 1-9 të Mocionit të Mbrojtjes së Thaçit për Ruajtjen e Provave të Mbrojtjes.

<sup>20</sup> Mocioni i Mbrojtjes së Thaçit për Ruajtjen e Provave të Mbrojtjes, para. 25.

<sup>21</sup> Mocioni i Mbrojtjes së Thaçit për Ruajtjen e Provave të Mbrojtjes, para. 34 (dhe para. 35, në lidhje me deponimet e mundshme në shkurt 2023).

9. Më 2 shkurt 2023, Trupi Gjykses hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për ruajtjen e provave të dëshmitarëve në fjalë.<sup>22</sup>
10. Më 3 prill 2023, filloi gjykimi.<sup>23</sup>
11. Gjatë konferencës mbi ecurinë e çështjes më 1 tetor 2024, mbrojtësi i z. Thaçi bëri të ditur se, për të filluar paraqitjen e provave, do t'i duheshin midis katër deri në gjashtë javë pas vendimit sipas rregullës 130.<sup>24</sup>
12. Më 22 janar 2025, të katër ekipet e Mbrojtjes bënë të ditur se do të kërkonin dhjetë javë midis datës së lëshimit të vendimit sipas rregullës 130 dhe fillimit të paraqitjes së provave të tyre, pa llogaritur periudhën e pushimit veror të gjykatës.<sup>25</sup>
13. Më 15 prill 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi njoftimin për mbylljen e paraqitjes së provave të saj.<sup>26</sup>
14. Më 5 qershor 2025, Trupi Gjykses lëshoi urdhrin e rishikuar për caktimin e afateve ("Urdhri i Rishikuar i Afateve"), në të cilin informoi palët dhe pjesëmarrësit se, në qoftë se do të rrëzonte tërësisht ose pjesërisht mocionin sipas rregullës 130, Trupi Gjykses planifikonte të mbante konferencën përgatitore për Mbrojtjen sipas rregullës 119(3) gjatë javës që fillonte të hënë, 21 korrik 2025.<sup>27</sup>
15. Më 12 qershor 2025, Mbrojtja për të katër të akuzuarit (bashkërisht, "Mbrojtja") dorëzoi mocionin e përbashkët sipas rregullës 130 ("Mocioni sipas Rregullës 130").<sup>28</sup>

---

<sup>22</sup> F01250, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Ruajtjen e Provave*, 2 shkurt 2023, para. 24, 34, 41, 43(i).

<sup>23</sup> Transkripti i seancës, 3 prill 2023. *Shih gjithashtu Urdhrin Gojor në lidhje me hapjen e çështjes*, Transkriptin e seancës, 15 shkurt 2023, f. 2038-2039.

<sup>24</sup> Transkripti i seancës, 1 tetor 2024, f. 20557.

<sup>25</sup> Transkripti i seancës, 22 janar 2025, f. 24343. *Shih gjithashtu Transkriptin e seancës*, 19 shkurt 2025, f. 25462.

<sup>26</sup> F03121, Prokurorja e Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë sipas Rregullës 129*, 15 prill 2025.

<sup>27</sup> F03232, Trupi Gjykses, *Urdhri i Rishikuar për Caktimin e Afateve*, 5 qershor 2025, para. 11, 12(f).

<sup>28</sup> F03256, Mbrojtja, *Mocion i Përbashkët i Mbrojtjes sipas Rregullës 130*, 12 qershor 2025, konfidencial, me Shtojcat 1-2, konfidenciale.

16. Më 13 qershor 2025, Mbrojtja dorëzoi kërkesë të përbashkët për ndryshimin e afateve të përcaktuara në Urdhrin e Rishikuar të Afateve (“Kërkesa e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afateve të Rishikuara”), ku kërkoi ndryshimin e afateve të caktuara për parashtrimin e listës së dëshmitarëve dhe të provave materiale dhe mbajtjen e konferencës përgatitore për Mbrojtjen.<sup>29</sup> Mbrojtja theksoi gjithashtu se megjithëse po zhvilloheshin diskutime dhe negociata me dhënësit e informacionit sipas rregullës 107, ky proces “nuk mund të përparonte në mënyrë të njëmendtë, derisa të finalizoheshin plotësisht provat dhe argumentet e ZPS-së, përfshirë kuadri i materialeve të pranuar”.<sup>30</sup>

17. Më 2 korrik 2025, Trupi Gjykses lëshoi një vendim në të cilin miratoi pjesërisht Kërkesën e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afateve të Rishikuara, dhe njoftoi palët dhe pjesëmarrësit se: (i) Trupi Gjykses do ta mbajë konferencën përgatitore për Mbrojtjen sipas rregullës 119(3) të martën, më 19 gusht 2025; dhe se (ii) palët dhe pjesëmarrësit duhet të përgatiten për fillimin e paraqitjes së provave të Mbrojtjes në javën vijuese (“Vendimi F03302”).<sup>31</sup>

18. Më 16 korrik 2025, Trupi Gjykses hodhi poshtë Mocionin sipas Rregullës 130.<sup>32</sup>

19. Më 21 korrik 2025, me urdhër të Trupit Gjykses,<sup>33</sup> Mbrojtja e Thaçit dorëzoi listën e dëshmitarëve të saj, e cila përfshin disa dëshmitarë të evidentuar në Mocionin e Mbrojtjes së Thaçit për Mundësi Hetimore Unike,<sup>34</sup> dhe listën e

---

<sup>29</sup> F03258, Mbrojtja, *Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afateve* (“Kërkesa për Ndryshimin e Afateve e Datës 13 Qershor 2025”), 13 qershor 2025, para. 2.

<sup>30</sup> Kërkesa për Ndryshimin e Afateve e Datës 13 Qershor 2025, para. 6.

<sup>31</sup> F03302, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Ndryshimin e Afateve*, 2 korrik 2025, para. 18, 27(e).

<sup>32</sup> Transkripti i seancës, 16 korrik 2025, f. 26190, rreshti 12, deri në f. 26195, rreshti 15.

<sup>33</sup> Urdhri i Rishikuar për Caktimin e Afateve, para. 10, 12(e); Vendimi F03302, para. 27(b).

<sup>34</sup> F03357/A01, Mbrojtja, *Shtojca 1 e Parashtrimit prej Mbrojtjes së Thaçit të Listës së Dëshmitarëve dhe Listës së Proovave Materiale*, 21 korrik 2025, konfidenciale dhe *ex parte* (versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua po atë ditë, F03357/A03).

provave materiale të saj ("Lista e Provave Materiale").<sup>35</sup> Po atë ditë, edhe Mbrojtja e Jakup Krasniqit ("Mbrojtja e Krasniqit") dorëzoi listën e dëshmitarëve<sup>36</sup> dhe listën e provave materiale të saj.<sup>37</sup>

20. Më 22 korrik 2025, Trupi Gjykses mbajti një konferencë mbi ecurinë e çështjes, ku palët kërkuan bashkërisht që dhënia e dëshmive prej dëshmitarëve të Mbrojtjes të mos fillonte para 15 shtatorit 2025.<sup>38</sup>

21. Po atë ditë, Mbrojtja e Kadri Veselit ("Mbrojtja e Veselit") bëri një kërkesë gojore për zgjatjen e afatit për t'iu përgjigjur tri mocioneve të Mbrojtjes së Viktimave ("Kërkesa e Mbrojtjes së Veselit").<sup>39</sup>

22. Gjithashtu, më 22 korrik 2025, palët bënë parashtrime gojore në lidhje me Listat e Provave Materiale të dorëzuara nga Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja e Krasniqit.<sup>40</sup>

---

<sup>35</sup> F03357/A02, Mbrojtja, Shtojca 2 e Parashtrimit prej Mbrojtjes së Thaçit të Listës së Dëshmitarëve dhe Listës së Provave Materiale, 21 korrik 2025, konfidenciale and *ex parte* (versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua po atë ditë, F03357/A04).

<sup>36</sup> F03358/A01, Mbrojtja, Shtojca 1 e Parashtrimit prej Mbrojtjes së Krasniqit të Listës së Dëshmitarëve dhe Listës së Provave Materiale, 21 korrik 2025, konfidenciale.

<sup>37</sup> F03358/A02, Mbrojtja, Shtojca 2 e Parashtrimit prej Mbrojtjes së Krasniqit të Listës së Dëshmitarëve dhe Listës së Provave Materiale, 21 korrik 2025, konfidenciale.

<sup>38</sup> CRSPD855, Mesazh elektronik nga ZPS-ja drejtuar Trupit Gjykses në lidhje me rendin e ditës për konferencën mbi ecurinë e çështjes më 22 korrik 2025, 21 korrik 2025, konfidencial; Transkripti i seancës (jopërfundimtar), 22 korrik 2025, konfidencial, f. 26374-26378.

<sup>39</sup> Transkripti i seancës (jopërfundimtar), 22 korrik 2025, konfidencial, f. 26425-26426, që i referohet F03349, Mbrojtja e Viktimave, Kërkesë e Mbrojtjes së Viktimave për Rishikim të Pjesshëm të Vendimit mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Viktimave në lidhje me Pranimin e Dokumenteve si Prova Jogojore, 18 korrik 2025, konfidenciale; F03362, Mbrojtja e Viktimave, Mocion i Mbrojtjes së Viktimave për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera, 23 korrik 2025, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, F03362/RED); F03363, Mbrojtja e Viktimave, Kërkesë e Mbrojtjes së Viktimave për Pranimin e Provave sipas Rregullës 153 dhe Rregullës 155 dhe Kërkesë në Lidhje me To, 23 korrik 2025, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale.

<sup>40</sup> Transkripti i seancës (jopërfundimtar), 22 korrik 2025, konfidencial, f. 26393, 26396-26402.

## II. PARASHTRIMET

### A. CAKTIMI I DATËS PËR FILLIMIN E PARAQITJES SË PROVAVE TË MBROJTJES

23. Mbrojtja e Thaçit parashtrohet se, kur urdhëroi Mbrojtjen e Thaçit që të ishte e gatshme të paraqiste provat e veta deri më 25 gusht 2025, Trupi Gjykses shkurtoi, pa paralajmërim dhe pa marrë mendimin e Mbrojtjes, kohën e disponueshme për përgatitjen e paraqitjes së provave të Mbrojtjes.<sup>41</sup> Mbrojtja e Thaçit më tej parashtrohet se, për pasojë, nuk do të ketë kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur si duhet për paraqitjen e provave dhe nuk do të mund t'u përmbahet disa afateve të caktuara nga Trupi Gjykses, në veçanti lidhur me përmbushjen e detyrimeve të nxjerrjes së provave në lidhje me informacionin që është objekt i autorizimit sipas rregullës 107.<sup>42</sup>

24. Mbrojtja e Krasniqit u bashkohet parashtimeve të Mbrojtjes së Thaçit dhe shton se as Mbrojtja e Krasniqit nuk do të jetë në gjendje të fillojë paraqitjen e provave të veta javën e 25 gushtit 2025.<sup>43</sup>

25. ZPS-ja parashtrohet se shtyrja e kërkuar është po aq e nevojshme edhe për ZPS-në, që ajo të mund të përgatitet për paraqitjen e provave të Mbrojtjes.<sup>44</sup>

26. Mbrojtja e Viktimave nuk ngriti asnjë kundërshtim në lidhje me këtë.<sup>45</sup>

### B. LISTA E PROVAVE MATERIALE TË THAÇIT DHE TË KRASNIQIT

27. Mbrojtja e Thaçit parashtrohet se Lista e Provave Materiale të saj përfshin dokumente që "mund" t'i paraqesë gjatë gjykimit, në përputhje me praktikën e deritanishme të ZPS-së dhe të Trupit Gjykses në lidhje me listën e provave

---

<sup>41</sup> Transkripti i seancës (jopërfundimtar), 22 korrik 2025, konfidencial, f. 26376.

<sup>42</sup> Transkripti i seancës jopërfundimtar ), 22 korrik 2025, konfidencial, f. 26374-26377.

<sup>43</sup> Transkripti i seancës (jopërfundimtar), 22 korrik 2025, konfidencial, f. 26377-26378, 26389.

<sup>44</sup> Transkripti i seancës (jopërfundimtar), 22 korrik 2025, konfidencial, f. 26378.

<sup>45</sup> Transkripti i seancës (jopërfundimtar), 22 korrik 2025, konfidencial, f. 26378.

materiale të dorëzuar nga ZPS-ja.<sup>46</sup> Trupi Gjykses thekson se parashtrimi i Krasniqit i 21 korrikut 2025 përmban gjuhë të ngjashme.<sup>47</sup>

28. Gjatë konferencës mbi ecurinë e çështjes më 22 korrik 2025, Trupi Gjykses pyeti të dy ekipet e Mbrojtjes nëse kishin zbatuar standardin përkatës të rregullës 119(2)(b) ('synon të paraqesë') për vlerësimin dhe evidentimin e dokumenteve të përfshira në Listat e Provave Materiale të tyre.<sup>48</sup>

### C. KËRKESA E MBROJTJES SË VESELIT PËR ZGJATJE TË AFATIT

29. Mbrojtja e Veselit kërkon zgjatjen e afatit për t'iu përgjigjur tre mocioneve të Mbrojtjes së Viktimave deri të hënën, 25 gusht 2025, duke pasur parasysh pushimin e ardhshëm të gjykatës, praktikën e deritanishme të Trupit Gjykses, dhe faktin se zgjatja e kërkuar e afatit nuk do të vononte fillimin e paraqitjes së provave të Mbrojtjes.<sup>49</sup>

30. Mbrojtja e Viktimave nuk kundërshton Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit.<sup>50</sup>

## III. DISKUTIM

### A. PLANIFIKIMI I PARAQITJES SË PROVAVE TË MBROJTJES

31. Nga ajo që u tha më lart është e qartë se Mbrojtja e Thaçit kishte synuar që në tetor 2022, të thërriste për të dhënë dëshmi së paku gjashtë nga personat aktualisht të përfshirë në listën e dëshmitarëve të saj, e cila përmban 12 dëshmitarë. Mbrojtja e Thaçit në vazhdimësi përsëriti se ishte në pozitë t'i thërriste këta dëshmitarë dhe propozoi disa data për atë qëllim. Ajo ka theksuar vazhdimisht se provat e tyre janë kyçe dhe thelbësore për argumentet e saj. Duke pasur parasysh pozitën që

---

<sup>46</sup> *Shih* Transkriptin e seancës (jopërfundimtar), 22 korrik 2025, konfidencial, f. 26396-26397, 26399.

<sup>47</sup> F03358, *Parashtrim prej Mbrojtjes së Krasniqit të Listës së Dëshmitarëve dhe Listës së Provave Materiale*, 21 korrik 2025, me Shtojcat 1 dhe 2, konfidenciale, para. 3.

<sup>48</sup> Transkripti i seancës (jopërfundimtar), 22 korrik 2025, konfidencial, f. 26389-26390.

<sup>49</sup> *Shih më lart* para. 21, poshtëshënimi 39.

<sup>50</sup> Transkripti i seancës (jopërfundimtar), 22 korrik 2025, konfidencial, f. 26426.

këta dëshmitarë kishin gjatë periudhës së Aktakuzës, Mbrojtja e Thaçit duhej ta kishte ditur plotësisht, së paku që nga tetori 2022, se për dëshmitë e tyre me gjasë do të duhej autorizim sipas rregullës 107 nga subjektet përkatëse.<sup>51</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se Mbrojtja e Thaçit pati më shumë se dy vjet e gjysmë që të kërkonte dhe merrte në kohë autorizimin sipas rregullës 107 që do t'i mundësonte të thërriste këta dëshmitarë për të dëshmuar në gjykim. Gjithashtu, Mbrojtja e Thaçit duhej të kishte qenë e vetëdijshme për nevojën e sigurimit të këtij autorizimi edhe në lidhje me tre persona të tjerë nga lista e dëshmitarëve të saj, duke pasur parasysh pozitat që këta persona kishin në kohën përkatëse. Trupi Gjykses nuk ka nevojë të hetojë në këtë fazë se çfarë hapash u ndërmoren apo se kur duhet të sigurohet autorizimi. Megjithatë, Trupi Gjykses thekson se ky problem duhej të ishte zgjidhur prej kohësh, veçanërisht duke pasur parasysh parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçi në tetor 2022 dhe janar 2023 lidhur me rëndësinë që kanë këta dëshmitarë për Mbrojtjen, pozitat që kishin ata gjatë periudhës së Aktakuzës, dhe propozimet që ata të jepnin dëshmitë në shkurt dhe prill 2023.<sup>52</sup>

32. Trupin Gjykses e shqetëson thellë fakti që ky problem është ende i pazgjidhur. Siç e ka bërë të qartë vazhdimisht, është përgjegjësi e palës thirrëse të sigurojë që dëshmitarët e saj të jenë të gatshëm të dëshmojnë në kohën e planifikuar për dëshmitë e tyre. Dihet prej vitesh se 15 prilli 2025 ishte data e synuar për mbylljen e paraqitjes së provave të ZPS-së dhe se, në qoftë se Mbrojtja do të vendoste të paraqiste prova, do të duhej të fillonte me paraqitjen e tyre shumë shpejt pas kësaj. Synimi i Mbrojtjes së Thaçit për të thirrur dëshmitarë për të dëshmuar në kuadër të paraqitjes së provave të saj ka qenë i qartë të paktën që nga tetori 2022.

33. Trupi Gjykses vë në dukje gjithashtu se, përveç autorizimit sipas rregullës

---

<sup>51</sup> *Shih më lart*, para. 1-2.

<sup>52</sup> Mocioni i Mbrojtjes së Thaçit për Mundësi Hetimore Unike, para. 32. Mocioni i Mbrojtjes së Thaçit për Ruajtjen e Provave të Mbrojtjes, para. 34.

107 që pritet në lidhje me nëntë dëshmitarët e mundshëm të Mbrojtjes së Thaçit, Mbrojtja e Thaçit dhe e Krasniqit nuk kanë dhënë asnjë arsye që do të përlligite shtyrjen e fillimit të paraqitjes së provave të Mbrojtjes.

34. Sido që të jetë, për t'i mundësuar Mbrojtjes së Thaçit përfundimin e procesit të sigurimit të autorizimit të nevojshëm pa vonesa të mëtejshme, dhe për të garantuar kryerjen e drejtë dhe me rregull të procesit, duke mbajtur parasysh marrëveshjen e palëve dhe në mungesë të kundërshtimeve nga Mbrojtja e Viktimave,<sup>53</sup> si dhe duke pasur parasysh rregullën 119(4), Trupi Gjykues informon palët se ka ndërmend të caktojë të hënën, 15 shtator 2025, si datë për fillimin e paraqitjes së provave të Mbrojtjes. Kjo datë do të caktohet zyrtarisht gjatë konferencës përgatitore për Mbrojtjen që është planifikuar të mbahet të martën, më 19 gusht 2025, në përputhje me rregullën 119(4).

35. Trupi Gjykues gjithashtu përsërit urdhrin drejtuar Mbrojtjes që: (i) të përfundojë nxjerrjen e materialeve të mbetura sipas rregullës 104(5), përfshirë në lidhje me dëshmitarët dhe provat materiale për të cilat nevojitet autorizim sipas rregullës 107 e që ende nuk është marrë, në vijimësi dhe jo më vonë se të hënën, 18 gusht 2025; dhe që (ii) të dorëzojë, deri të hënën, 18 gusht 2025, informacionin e përcaktuar në paragrafin 74 të Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit,<sup>54</sup> përfshirë renditjen paraprake sipas të cilës do të thirren dëshmitarët e Mbrojtjes.<sup>55</sup>

36. Gjithashtu, duke mbajtur parasysh parashtrimet Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me këtë,<sup>56</sup> Trupi Gjykues urdhëron Mbrojtjen e Thaçit që deri të hënën, 18 gusht 2025, të dorëzojë kërkesat sipas rregullës 154 në lidhje me dëshmitarin sipas rregullës 154 të përmendur me emër në Shtojcën 3 të Listës së Dëshmitarëve

---

<sup>53</sup> CRSPD855, *Mesazh elektronik i ZPS-së drejtuar Trupit Gjykues në lidhje me rendin e ditës për konferencën mbi ecurinë e çështjes më 22 korrik 2025*, 21 korrik 2025, konfidencial; Transkripti i seancës (jopërfundimtar), 22 korrik 2025, konfidencial, f. 26374-26378.

<sup>54</sup> F01226/A01, Trupi Gjykues, *Shtojca 1 e Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit* ("Urdhri mbi Zhvillimin e Gjykimit"), 25 janar 2023.

<sup>55</sup> Vendimi F03302, para. 25, 27(d).

<sup>56</sup> Transkripti i seancës (jopërfundimtar), 22 korrik 2025, konfidencial, f. 26406, rreshtat 7-10.

të Mbrojtjes së Thaçit. Krahas kësaj, Trupi Gjykses dëshiron t'u rikujtojë ekipeve të Mbrojtjes se i inkurajon fuqimisht: (i) të dorëzojnë kërkesat e mbetura sipas rregullës 154 pa vonesë dhe të paktën tre javë përpara datës së parashikuar për dëshminë e dëshmitarit përkatës; si dhe (ii) të jenë të gatshme të dorëzojnë, sa më herët që të jetë e mundur, mocionet sipas rregullës 153 dhe rregullës 155, për të shmangur vonesat e panevojshme, dhe mjaftueshëm në kohë para përfundimit të paraqitjes së provave të ekipit përkatës të Mbrojtjes.<sup>57</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses informon Mbrojtjen se ka ndërmend që, në konferencën përgatitore për Mbrojtjen, të caktojë afatet për dorëzimin e kërkesave sipas rregullave 153 dhe 155.<sup>58</sup> Trupi Gjykses gjithashtu u kujton palëve që të zhvillojnë diskutime *inter partes* për të arritur marrëveshje nëse dëshirojnë që Trupi Gjykses të thërrasë dëshmitarët sipas rregullës 153 për t'u marrë në pyetje, në përputhje me paragrafin 39 të Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit.

37. Trupi Gjykses më tej vë në dukje se koha shtesë e miratuar për Mbrojtjen e Thaçit dhe të Krasniqit nuk duhet të cenohet të drejtën e të pandehurve të tjerë dhe interesat e viktimave për një gjykim pa vonesa të papërligjura. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses fton Mbrojtjen e Thaçit dhe të Krasniqit të shqyrtojnë me kujdes mundësinë e shfrytëzimit të tri javëve shtesë (25 gusht – 15 shtator 2025) për të dorëzuar disa, nëse jo të gjitha, nga mocionet lidhur me provat jогоjore që do të jenë në gjendje të përgatisin dhe përfundojnë gjatë asaj periudhe.

#### B. LISTAT E PROVAVE MATERIALE TË MBROJTJES SË THAÇIT DHE TË KRASNIQIT

38. Duke pasur parasysh parashtrimet e palëve dhe faktin se Listat e Provave Materiale të Mbrojtjes së Thaçit dhe të Krasniqit mund të përfshijnë më shumë dokumente sesa Mbrojtja “ka ndërmend të paraqesë” në kuadër të paraqitjes së provave të saj,<sup>59</sup> dhe për të siguruar kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit,

<sup>57</sup> Vendimi F03302, para. 26.

<sup>58</sup> *Shih* Vendimin F03302, para. 24.

<sup>59</sup> Transkripti i seancës (jopërfundimtar), 22 korrik 2025, konfidencial, f. 26393, 26396-26402.

Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen e Thaçit dhe Mbrojtjen e Krasniqit që deri më 15 gusht 2025, në orën 4 pasdite, të dorëzojnë versionet e rishikuara të Listave të Provave Materiale të tyre ku të përfshihen vetëm provat materiale që kanë ndërmend t'i paraqesin gjatë gjykimit, dhe nga listat aktuale të heqin materialet që nuk kanë ndërmend t'i paraqesin, në përputhje me rregullën 119(2)(b). Në qoftë se Mbrojtja e Thaçit dhe e Krasniqit kanë ndërmend t'i paraqesin të gjitha materialet aktualisht të përfshira në ato lista, brenda të njëjtit afat duhet t'i dorëzojnë Trupit Gjykses Njoftim, ku ta njoftojnë Trupin Gjykses në lidhje me këtë.

39. Trupi Gjykses më tej inkurajon Mbrojtjen e Thaçit dhe të Krasniqit që sa më shpejtë që të jetë praktike dhe përpara 19 gushtit 2025, të zhvillojnë diskutime *inter partes* me ZPS-në lidhur me pranueshmërinë e provave materiale të propozuara.

#### C. KËRKESA E MBROJTJES SË VESELIT PËR ZGJATJE TË AFATIT

40. Në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për zgjatjen e afatit për t'u përgjigjur ndaj tre mocioneve të Mbrojtjes së Viktimave,<sup>60</sup> Trupi Gjykses gjykon se nuk janë treguar arsye bindëse që përlligjin zgjatjen e kërkuar të afatit. Trupi Gjykses veçanërisht vlerëson se Mbrojtja e Veselit ka qenë e njoftuar se Mbrojtja e Viktimave mund të dorëzojë të paktën dy prej mocioneve,<sup>61</sup> nuk po përgatitet të paraqesë provat e saj,<sup>62</sup> aspektet që debatohen kanë kuadër të kufizuar, dhe rrjedhimisht nuk ka treguar arsye të mjaftueshme përse nevojitet zgjatje afati.

---

<sup>60</sup> *Shih më lart*, para. 21, poshtëshënimin 39; para. 29, poshtëshënimin 49.

<sup>61</sup> F03205, Mbrojtja e Viktimave, *Parashtrime të Mbrojtjes së Viktimave në lidhje me Paraqitjen e Provave të Mbrojtjes së Viktimave*, 28 maj 2025, para. 9; Transkripti i seancës, 17 korrik 2025, f. 26370, rreshtat 13-23; F03340, Trupi Gjykses, *Vendim Përmbledhës mbi Kërkesat e Mbrojtjes së Viktimave për Pranimin e Informacionit Plotësues lidhur me Dëmin (F03208, F03279, dhe F03301)*, 17 korrik 2025, para. 23-24, 26(b).

<sup>62</sup> F03338, Mbrojtja, *Njoftim i Mbrojtjes së Veselit i Synimit për Mosparaqitjen e Provave të Mbrojtjes*, 16 korrik 2025, para. 1.

41. Rrjedhimisht, në interes të kryerjes së shpejtë të procesit, Trupi Gjykses refuzon Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit.

#### IV. VENDIM

42. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **INFORMON** palët dhe pjesëmarrësit se Trupi Gjykses ka ndërmend të caktojë të hënën, 15 shtator 2025, si datë për fillimin e paraqitjes së provave nga Mbrojtja;
- b) **PËRSËRIT** urdhrin drejtuar Mbrojtjes që: (i) të përfundojë çdo nxjerrje të mbetur të materialit sipas rregullës 104(5), përfshirë në lidhje me dëshmitarë dhe prova materiale për të cilat nevojitet autorizim nga dhënësi i informacionit sipas rregullës 107 e që ende nuk është marrë, në vijimësi dhe jo më vonë se të hënën, 18 gusht 2025; dhe që (ii) të dorëzojë informacionin e shtjelluar në paragrafin 74 të Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit, deri të hënën, 18 gusht 2025;
- c) **I RIKUJTON** Mbrojtjes së Thaçit dhe të Krasniqit se inkurajohen fuqimisht: (i) të dorëzojnë çdo kërkesë tjetër sipas rregullës 154 pa vonesë dhe të paktën tri javë para datës së dhënies së dëshmisë së dëshmitarit përkatës; dhe (ii) të jenë të gatshme të dorëzojnë mocionet sipas rregullës 153 dhe rregullës 155 sa më parë, për të shmangur vonesat e panevojshme, dhe mjaftueshëm në kohë para përfundimit të paraqitjes së provave të ekipit të Mbrojtjes në fjalë;
- d) **I RIKUJTON** Mbrojtjes së Thaçit dhe të Krasniqit se inkurajohen fuqimisht të shfrytëzojnë kohën shtesë të miratuar për përgatitjen e

- paraqitjes së provave të tyre për të përgatitur dhe dorëzimin e mocioneve lidhur me provat jогоjore gjatë asaj periudhe;
- e) **INFORMON** Mbrojtjen e Thaçit dhe të Krasniqit se gjatë konferencës përgatitore për Mbrojtjen, Trupi Gjykues ka ndërmend të caktojë afatet për dorëzimin e të gjitha mocioneve sipas rregullës 153 dhe 155, dhe mund të caktojë afate edhe në lidhje me mocionet për provat jогоjore;
- f) **URDHËRON** Mbrojtjen e Thaçit dhe të Krasniqit që, deri më 15 gusht 2025, në orën 4 pasdite, të dorëzojnë versionet e rishikuara të Listave të Provave Materiale të tyre ku të përfshijnë vetëm provat materiale të propozuara që kanë ndërmend t'i paraqesin gjatë gjykimit, ose të dorëzojnë Njoftim se kanë ndërmend të paraqesin në gjykim materialet që aktualisht gjenden në Listën e Provave Materiale; dhe
- g) **REFUZON** Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për zgjatje të afatit.

/nënshkrimi/

**Gjykatës Çarls L. Smith, III**

**Kryegjykatës**

E premte, 25 korrik 2025

Hagë, Holandë.